

VENDIM
Nr.1828, datë 4.7.2007

**PËR SHPALLJEN E REZULTATIT PËRFUNDIMTAR TË ZGJEDHJEVE TË PJESSHME
PËR DEPUTET NË KUVENDIN E SHQIPËRISË, NË ZONËN ZGJEDHORE NR.86, TË
DATËS 17.6.2007**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e tij të datës 4.7.2007, me pjesëmarrjen e:

Çlirim Gjata	Kryetar
Flamur Çato	Zv/Kryetar
Arben Ristani	Anëtar
Dëshira Subashi	Anëtare
Dodë Prenga	Anëtar
Fatmir Kumbaro	Anëtar
Genti Shala	Anëtar
Klement Zguri	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me

OBJEKT: Për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve të pjesshme për deputet në Kuvendin e Shqipërisë, në Zonën Zgjedhore nr.86, të datës 17.6.2007.

BAZË LIGJORE: Neni 2, pika 34 germa "a", neni 29, pika 1, të ligjit nr.9087, datë 19.6.2003 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

KQZ, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e të pranishmëve,

VËREN:

Në datë 17.6.2007, në zonën zgjedhore nr.86, u zhvilluan zgjedhjet e pjesshme për deputet në Kuvendin e Shqipërisë. Në bazë të nenit 117, pika 1, të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, z.Sajmir Kodra, kandidat për deputet në ZZ nr.86, i kërkoi KQZ-së shpalljen të pavlefshme të zgjedhjeve në këtë njësi zgjedhore. KQZ-ja me vendimin nr.1826, datë 24.6.2007 "Për shqyrtimin e kërkesës nr.1 të subjektit zgjedhor z.Sajmir Kodra, kandidat për deputet në ZZ nr.86, për shpalljen të pavlefshme të zgjedhjeve në zonën zgjedhore nr.86, për zgjedhjet e pjesshme për deputet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 17.6.2007", vendosi rrëzimin e kërkesës.

Vendimi i mësipërm i KQZ-së u ankimua nga z.Sajmir Kodra në Kolegjin Zgjedhor në Gjykatën e Apelit Tiranë. Kolegji Zgjedhor në Gjykatën e Apelit Tiranë, me vendimin nr.121, datë 4.7.2006, vendosi mospranimin e kërkesës së z.Sajmir Kodra dhe lënien në fuqi të vendimit nr.1826, datë 24.6.2007 të KQZ-së.

Në referim të përcaktimeve të nenit 29 dhe nenit 2, pika 34 germa "a", të Kodit Zgjedhor, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve shpall me vendim rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve në këtë zonë zgjedhore.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, duke qenë se procesin e numërimit e bëri vetë në ambientet e KQZ-së, me vendimin nr.1822, datë 19.6.2007, ka vendosur të miratojë rezultatit e zgjedhjeve për kandidat për deputet në Kuvendin e Shqipërisë në zonën zgjedhore nr.86 dhe të shpallë fitues z.Eris Hoxha, kandidat i mbështetur nga Partia Demokratike. Kolegji Zgjedhor, në përfundim të ankimeve zgjedhore, la në fuqi rezultatit e zgjedhjeve të miratuar nga KQZ-ja.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, mbështetur në nenin 2, pika 34 germa "a", nenin 29, pika 1, të ligjit nr.9087, datë 19.6.2003 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar,

VENDOSI:

Të shpallë rezultatit e zgjedhjeve për deputet në Kuvendin e Shqipërisë në zonën zgjedhore

nr.86 të datës 17.6.2007, duke shpallur fitues z.Eris Hoxha, kandidat i mbështetur nga Partia Demokratike.